



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike
Mbledhja nr. 03
Prishtinë, më 01 shkurt 2012, në orën 10:00 salla N-10
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR MBIKËQYRJEN E FINANCEVE PUBLIKE

Në mbledhje morën pjesë: Ali Sadriu, Ramiz Lladrovci, Mursel Haljilji, Valbona Dibra, Armend Zemaj, Afrim Hoti, Adem Grabovci dhe Albert Kinolli.

Mungoi: Bali Muharremaj.

I ftuar: z.Lars Lage OLOFSSON, auditor i përgjithshëm

Stafi Mbështetës i Komisionit: Fatime Qorri - koordinatore, KIPRED (staf mbështetës) – Albert Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi: Ali Sadriu - kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Shqyrtimi i propozimplanit të punës së Komisionit për vitin 2012,
3. Të Ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se ishin plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, njëzëri miratoi rendin e ditës pa ndryshime.

3. Shqyrtimi i propozimplanit të punës së Komisionit për vitin 2012,

Kryetari – Tha se objektiv kryesor gjatë punës së tij Komisioni ka mbikëqyrjen e shpenzimit të parasë publike.

ZAP ka planifikuar të procedoj rreth 101 raporte. Ka planifikuar auditime të rregullsisë, të menaxhimit janë planifikuar shtatë, ndërsa të performancës janë planifikuar katër. Komisioni gjatë vitit 2011 ka bërë kërkesë për auditim të performancës edhe për Komisionin për miniera dhe minerale, për Telekomunikacionin etj, këto ZAP nuk i ka marrë për bazë. Nëse ZAP nuk ka kapacitet Komisioni, do të gjejë burime financiare dhe do ta bëjë këtë.

Ramiz Lladrovci – Kritikoi ZAP-in që ka proceduar me vonesë planin e punës, sepse si pasojë e kësaj ka pengesa në planin e punës së Komisionit dhe të Kuvendit. Komisioni ka kërkuar që në disa OB, të bëhet auditim i performancës si: Ministria e Shëndetësisë Ministria për Komunitete dhe Kthim etj. ZAP ka planifikuar disa auditime të menaxhmentit. Për këto institucione do të duhet të ishte auditim i performancës. ZAP në vitin e kaluar ka planifikuar pesë auditime të performancës dhe ka proceduar vetëm një. Në këtë vit janë planifikuar katër auditime të performancës. Pse, është planifikuar auditim i performancës për prokurim ekonomik dhe efikas të IT-së? Më mirë do të ishte të bëhej një auditim i MPB ose i MSH.

z.Lars Lage OLOFSSON – Në përgjithësi janë planifikuar 105 auditime, dy janë finalizuar. Draft raportet e auditimit nuk publikohen. Auditimet e performancës nga viti i kaluar nuk janë publikuar, sepse nuk kanë qenë të mjaftueshme për tu publikuar. ZAP ka pilot auditime ku po mësohet se si të kryhet “profesioni i ri” në Kosovë. Dhe nuk mund të jemi të suksesshëm në çdo punë që bëjmë. Informatat e marra gjatë këtyre proceseve ZAP po i përdor në dialog me Qeverinë. Auditimeve të menaxhimit dhe të performancës nuk i jepet opinion për pasqyrat vjetore financiare. Pra, auditimi fokusohet se si menaxhohet sistemi. Pra, mund të ketë drejtime të ndryshme.

ZAP ka tentuar të punoj sipas pikëpamjeve të Komisionit. Për MKK, ZAP ka planifikuar të shoh menaxhimin e sistemit, pastaj MSH ka një qasje të re, do të dalin shumë sfida - se si po menaxhohet kontrolli dhe informatat. E njëjta gjë po ndodh edhe me MPMS ku do të shikohet ndërlidhja e tyre me nivelin komunal, pasi që komuna është ajo që paguan subvencionet te qytetaret. KMM (Komisionit për miniera dhe minerale), dhe telekomunikacionit do t'i përkushtohet më shumë kohë, janë prioritet, por nuk është ndërruar emërtimi i auditimit-pra do të jetë auditim me opinion.

MPB – aty ku ka kontrole të nivelit tjetër, ZAP nuk ndërhyt. Aty do të mbetet auditim i rregullsisë. Është e njëjta situatë me MD ku janë përfshirë shumë akterë se si po kryhet puna aty.

Komunat- tre komuna në veri nuk kanë prodhuar pasqyra nëntëmujore. Atje nuk ka pasur mundësi të auditohen e njëjta ndodhë edhe me subvencione që shkojnë në këtë pjesë. Për momentin nuk kemi informata nga kjo pjesë.

Armend Zemaj – Komisioni në raport me ZAP-in, janë dakorduar që të jenë më dinamik. Çështjet preokupuese për Komisionin janë çështje për të cilat Komisioni ka dashur rezultate konkrete. Në auditimin - sistemi i kontrollit të barnave është dashur të përfshihet edhe asgjësimi i barnave, sepse ka 800-tonelata të grumbulluara dhe nuk dihet se çka po ndodhë me ato barna. Ka informacion se barnat që ju ka skaduar afati po rifuten në treg. Dhe e dyta është dashur të përfshihet edhe kontrolli për sigurinë e ushqimit.

Lidhur me ministritë ku janë të përfshirë akterët tjerë, ai tha se Komisioni kërkon përgjegjësi politike. Masat tjera burojnë nga raportet e ZAP-it dhe vendimet e Komisionit. Komisioni duhet të ketë një bashkëpunim me task - forcën dhe me prokurorinë e shtetit. Kjo mund të bëhet me ndonjë memorandum bashkëpunimi.

Komisioni është i interesuar të auditohet edhe skema sociale. Kjo është një “gangrenë” për Buxhetin e Kosovës. Sepse, nuk janë duke përfutur ata që kanë nevojë. Kërkoi nga ZAP-i që të bëhet një auditim të veçantë lidhur me këtë. Ligji po ndryshohet tashmë për herën e tretë dhe ka probleme akoma.

Valbona Dibra - Ndau mendimin me deputetin Lladrovci për vonesën që ZAP ka në procedimin e planit, megjithatë falënderoj auditorin për një plan voluminoz i cili kërkon angazhim të madh për përmbushje. Pyeti: sa janë të saktë në respektimin e afateve për procedim të raporteve të planifikuara? ZAP-i në disa sa komuna i ka të kontraktuara auditorët e jashtëm. A do të vazhdoj kjo praktikë edhe në planifikimin e radhës për vitin 2012/2013?

Ramiz Lladrovci – Lidhur me ministrinë ku ZAP arsyetohet se nuk mund të bëjë auditim, sepse ka shumë vlerësues të tjerë pyeti: a ka presion ZAP-i apo pse nuk bënë një auditim të performancës? Komisionit i duhen informacione të detajuara se çka po ndodh në këto ministri. Komisioni është i interesuar të sqaroj gjendjen.

z.Lars Lage OLOFSSON – Lidhur me Ministrinë e transportit dhe e infrastrukturës, tha se ZAP nuk frikohet t'i auditoj. Është bërë një auditim se si është bërë mirëmbajtja e rrugëve dhe del se të gjitha kontratat e mirëmbajtjes për tre vitet e fundit janë në hetime të prokurorisë. ZAP nuk auditon raste ku është e kyçur prokuroria.

Ministria e shëndetësisë- do t'i bëhet një auditim i menaxhimit, por jo auditim i performancës. Nuk është kohë e mirë që kësaj ministrie t'i bëhet auditim i performancës, pasi i gjithë sistemi i shëndetësisë është në rishikim- me ligjet e reja.

MPMS – do të shpalos një numër sfidash kur behët fjalë për skemën e përfituesve social. ZAP do të vazhdoj më një qasje më të thellë në këtë drejtim.

Koha e planifikuar për dorëzim të raporteve është bërë në margjina mjaft të sakta dhe ZAP do t'i përmbahet asaj kohe. Ndoshta jo 100% por pothuajse të gjitha raportet do të bëhen sipas planit.

Kontraktimi i auditimeve të komunave nga jashtë - janë 18 komuna që do të auditohen nga kompanitë e kontraktuara. Në nëntë prej tyre janë kryer nga ZAP-i auditime të ndërmjetëme. Në sezonin ardhshëm ky numër do të ulet nga 12 nga 14. Plani është që në fund të mos përdoret asnjë firmë private për auditim.

Ramiz Lladrovci – Mirëmbajtja e rrugëve- drejtorja e rrugëve ka lejuar që të shtrohet rrugët-mirëmbahen rrugët, pa u respektuar asnjë kriter. Fjala është për rrugët regjionale. Nuk ka informacion që ajo drejtori është nënë hetime dhe ka lejuar për të mos u respektuar asnjë standard për mirëmbajtjen e rrugëve. Këtë duhet ta ketë parasysh ZAP-i.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, njëzëri nxori këtë

Vendim

Miratohet Plani i Punës së Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike për vitin 2012.

4. Të ndryshme

Komisioni vazhdoi punimet në punëtorinë e organizuar në bashkëpunim me NDI-në.

Mbledhja përfundoi në orën 11:00

E Përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Ali Sadriu